

PHILIPS

Boks me valë

4000 Series

S4807



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në:

www.philips.com/support

Përmbajtja

1	E rëndësishme	2
	Siguria	2
2	Boksi me valë	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Përmbledhje për boksin	3
3	Fillimi	4
	Karikimi i baterisë së brendshme	4
	Ndezja/fikja	4
4	Luajtja nga pajisjet me Bluetooth	5
	Luajtja nga pajisjet me Bluetooth	5
	Lidhje në disa pika	5
	Kontrollimi i luajtjes	6
	Kontrollimi i telefonatës	6
	Aktivizoni asistentin me zë të pajisjes suaj celulare	6
	Çiftimi për modalitetin stereo	6
5	Informacione për produktin	7
6	Zgjidhja e problemeve	7
	Të përgjithshme	7
	Bluetooth	8
7	Njoftim	8
	Pajtueshmëria	8
	Kujdesi për mjedisin	8
	Deklarata FCC dhe IC	9
	Njoftim për markën tregtare	10

1 E rëndësishme

Siguria

Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin mbrapa ose poshtë pajisjes.
- Boksi nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vini asnjë burim rreziku mbi boks (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anembanë boksit për ajrim.
- Ju lutemi përdoreni boks në një ambient të sigurt me temperaturë ndërmjet 0°C dhe 45°C.
- Përdorni vetëm pjesë dhe aksesore që janë specifikuar nga prodhuesi.

Masa paraprake sigurie për baterinë

- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Bateria (paketa e baterive ose bateria e instaluar) nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt, si për shembull ndaj dritës së diellit, zjarrit ose gjërave të ngjashme.
- Në rast se bateria është në temperaturë ekstreme të lartë ose të ulët gjatë përdorimit, ruajtjes ose transportit, dhe në presion atmosferik të ulët në lartësi të mëdha, kjo mund të jetë e rrezikshme.
- Mos e ndërroni baterinë me një tip të gabuar (për shembull, disa lloje baterish litiumi).
- Hedhja e baterisë në zjarr ose në një furrë të nxehtë, ose shtypja apo prerja mekanikisht e baterisë mund të shkaktojë shpërthim.
- Lënia e baterisë në temperaturë tepër të lartë, ose në presion atmosferik tepër të ulët mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boks.
- Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij boks.
- Vendoseni boks mbi një sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Asnjëherë mos e vendosni boks mbi pajisje të tjera elektrike.
- Përdoreni boks vetëm brenda. Mbajeni boks larg nga uji, lagështia dhe nga objektet e mbushura me lëngje.
- Mbajeni boks larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria ndërrohet me një tip të gabuar.

2 Boksi me valë


Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Boksi
- Kablli USB
- Manuali i përdorimit
- Dokumenti i të dhënave të sigurisë
- Garancia botërore
- Rip

Përmbledhje për boksen



①

- Ndizeni ose fikeni boksen.

②

- Mbajeni shtypur për të hyrë në modalitetin e çiftimit stereo.

③

- Hyni në modalitetin e çiftimit me Bluetooth.
- Fshini informacionet e çiftimit me Bluetooth

④

- Në modalitetin e Bluetooth, shtypni për të ndaluar ose vazhduar luajtjen.
- Përgjigjuni një telefonate hyrëse me anë të lidhjes me Bluetooth.
- Mbajeni shtypur për të aktivizuar asistentin me zë të pajisjes suaj celulare.

⑤ **Treguesi LED i energjisë/Bluetooth**

- Drita e energjisë/Bluetooth

⑥ **Mikrofon**

⑦

- Ngrijeni volumn.

⑧

- Uleni volumn.

⑨ **Treguesit e nivelit të baterisë**

- Shfaqni procesin e karikimit.
- Shfaqni nivelin e baterisë: Për të parë statusin e baterisë, mbani shtypur cilindo buton tjetër por jo , pasi do të sinjalojë fikjen.

⑩ **DC IN**

- Karikoni baterinë e brendshme.

3 Fillimi

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.


Karikimi i baterisë së brendshme

Boksi vihet në punë nga një bateri e brendshme e karikueshme.

Shënim

- Karikojeni plotësisht baterinë e brendshme para se ta përdorni.
- Kur boksi ndizet dhe bateria është e ulët, treguesi LED i energjisë/Bluetooth pulson në ngjyrë të kuqe.

Lidhni një prizë USB-C në boks me një prizë (5 V = 2 A) duke përdorur kabllin USB të dhënë.




Ndezja

- ↳ Kur boksi është duke u karikuar, drita LED e energjisë/Bluetooth pulson me ngadalë në ngjyrë të kuqe.
- ↳ Kur boksi është i karikuar plotësisht, drita LED e energjisë/Bluetooth qëndron e bardhë.

Fikja

- ↳ Kur boksi është duke u karikuar, drita LED e energjisë/Bluetooth pulson me ngadalë në ngjyrë të kuqe.
- ↳ Kur boksi është i karikuar plotësisht, drita LED e energjisë/Bluetooth fiket.



Energjia e baterisë	LED1	LED2	LED3	LED4	LED e energjisë/Bluetooth
Plot	E bardhë solide				
>80%	E bardhë solide			Fikur	
50%- 80%	E bardhë solide		Fikur		
20%- 40%	E bardhë solide		Fikur		
Bateri e ulët < 20%	Fikur				Pulson në ngjyrë të kuqe



Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të boksit! Sigurohuni që tensioni i furnizimit me energji përputhet me tensionin që tregohet mbrapa ose poshtë boksit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur e shkëputni kabllon USB, tërhiqeni gjithnjë nga spina. Asnjëherë mos tërhiqni kabllon.
- Përdorni vetëm kabllon USB të specifikuar nga prodhuesi ose që shitet bashkë me këtë boks.

Ndezja/fikja

Shtypni  për ta ndezur boksën.

↳ Do të dëgjoni tingullin lajmërues.

Për ta fikur boksën, shtypni  përsëri.

↳ Do të dëgjoni tingullin lajmërues.



Shënim

- Boksi do të fiket automatikisht nëse nuk ka sinjal audio nga Bluetooth për 15 minuta.

4 Luajtja nga pajisjet me Bluetooth

Luajtja nga pajisjet me Bluetooth

Me këtë boks mund të dëgjoni audio nga pajisja juaj me Bluetooth.

Shënim

- Sigurohuni që funksioni Bluetooth është i aktivizuar në pajisje.
- Distanca maksimale për çiftimin e boksit dhe pajisjes me Bluetooth është 20 metra.
- Mbajeni larg nga çdo pajisje elektronike që mund të shkaktojë interferenca.

- 1 Shtypni  për ta ndezur boksën. Do të hyni automatikisht në modalitetin e çiftimit me Bluetooth. Gjithashtu mund të mbani shtypur  për 3 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit me Bluetooth.
- 2 Aktivizoni Bluetooth dhe zgjidhni "**Philips S4807**" në listën e Bluetooth në pajisjen tuaj për çiftim.
 - Nëse shfaqet një mesazh që kërkon leje për lidhjen me Bluetooth, konfirmojeni.
 - Nëse kërkohet fjalëkalim, formoni 0000 dhe pastaj konfirmojeni.
- 3 Luani audio në pajisjen tuaj me Bluetooth për të filluar transmetimin e muzikës.

Treguesi LED i energjisë/Bluetooth	Përshkrim
Pulson shpejt ngjyrë të bardhë	Gati për çiftim
Pulson ngadalë ngjyrë të bardhë	Duke u lidhur përsëri me pajisjen e fundit
E bardhë solide	Është lidhur

Shënim

- Për ta shkëputur një pajisje, mbani shtypur  për 3 sekonda derisa treguesi LED i energjisë/Bluetooth të pulsojë shpejt në ngjyrë të bardhë.
- Për t'i fshirë informacionet e çiftimit, mbani shtypur  për 8 sekonda derisa treguesi LED i energjisë/Bluetooth të pulsojë me ngadalë 3 herë në ngjyrë të bardhë.

Lidhje në disa pika

Çiftimi

- Çiftojeni boksën me dy pajisje, p.sh. me telefonin celular dhe me laptopin.

Çiftimi

- Muzika mund të luhet vetëm nga një pajisje njëherësh. Pajisja tjetër do të ruhet për telefonatë.
- Ndaloni audion nga një pajisje për të filluar luajtjen e audios nga pajisja tjetër.

Shënim

- Marra e një telefonate në pajisjen 2 do të ndalojë luajtjen në pajisjen 1. Telefonata do të kalohet automatikisht te boksja juaj.
- Mbyllja e telefonatës do të vazhdojë automatikisht luajtjen nga pajisja 1.

Kontrollimi i luajtjes

Gjatë luajtjes së muzikës



Shtypeni për të ndaluar ose vazhduar luajtjen

Shtypni dy herë për të kaluar te kënga tjetër



Rregulloni volumin

Kontrollimi i telefonatës



Shtypeni për t'iu përgjigjur një telefonate ose për ta mbyllur atë

Mbajeni shtypur për ta refuzuar një telefonatë



Rregulloni volumin

Aktivizoni asistentin me zë të pajisjes suaj celulare



Mbajeni shtypur për të aktivizuar asistentin me zë të pajisjes suaj celulare



Rregulloni volumin

Çiftimi për modalitetin stereo

Do bokse identike të njëjta (Philips S4807) mund të çiftohen me njëra-tjetrën për tingull stereo.



Shënim

- Çdo boks mund të përdoret si boks kryesor
- Boksi i lidhur me një pajisje me Bluetooth mund të përdoret vetëm si boks kryesor.
- Para se të bëni çiftimin stereo, sigurohuni që boksi dytësor është në modalitetin e çiftimit me Bluetooth.
- Mbani një distancë maksimale prej 20 metrash (66 feet) midis boksit dhe pajisjes suaj me Bluetooth.
- Në modalitetin stereo, funksioni i butonit në boksit dytësor është njëlloj si ai i boksit të parë.

- 1 Shtypni  për t'i ndezur të dy bokset, dhe ato do të hyjnë automatikisht në modalitetin e çiftimit me Bluetooth. Boksi i lidhur me pajisjen tuaj me Bluetooth do të përdoret si boks kryesor.
- 2 Në të dyja bokset, mbani shtypur  për të hyrë në modalitetin e çiftimit stereo derisa drita LED të pulsojë me radhë në ngjyrë të kuqe dhe të bardhë. Do të dëgjoni një tingull lajmërues kur lidhja të jetë bërë me sukses dhe drita LED e energjisë/Bluetooth do të jetë e bardhë solide.
- 3 Shtypni  në secilin boks. Muzika do të luhet në të dyja bokset.

Për të dalë nga modaliteti stereo, mbani shtypur  në secilin boks.

5 Informacione për produktin



Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar paraprakisht.

Informacione të përgjithshme

Portë USB	5 V $\equiv$ 2 A
Bateria e brendshme e litiumit	3,7 V, 4400 mAh
Përmasat (Gje x La x Tra)	170 x 70 x 72 mm
Pesha (njësia kryesore)	492 g
Temperatura e ambientit	0°C ~ 45°C
Kategoria e mbrojtjes IP	IP67*

* Klasifikimi IP67 do të thotë që drajveri i boksit është i izoluar nga pluhuri dhe mund të zhytet për deri në 30 minuta në një thellësi deri në 1 m.

Amplifikatori

Fuqia output (RMS)	10 W
Përgjigja e frekuencës	80 Hz - 20 KHz
Raporti sinjal-zhurmë	> 75 dB

Bokset

Impedanca	4 Ω
Fuqia maksimale input	10 W
Drajveri	44 x 80 mm
Radiatorë pasivë	2

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	5.2
Gama e frekuencës	2402 - 2480 MHz
Fuqia maksimale e transmetimit	< 10 dBm
Profilat e pajtueshme me Bluetooth	HFP V1.7
Rrezja e Bluetooth	deri në 20 m

6 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e boksit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni boksën vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni boksën, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime.

Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që boksë është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Të përgjithshme

Nuk ndizet

- Sigurohuni që boksë është karikuar plotësisht.
- Sigurohuni që priza USB e boksit është lidhur si duhet.
- Si veçori për kursimin e energjisë, boksë fiket vetë pas 15 minutash nëse nuk ka sinjal audio.

Nuk ka zë

- Rregulloni volumnin në këtë boksë.
- Rregulloni volumnin në pajisjen e lidhur.
- Sigurohuni që pajisja me Bluetooth të jetë brenda distancës funksionale.

Nuk ka përgjigje nga boksë

- Ndizeni përsëri boksën.

Bluetooth

Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje me Bluetooth

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni pajisjen më shumë boksën ose hiqni çdo pengesë mes tyre.

Nuk gjeni dot [Philips S4807] në pajisjen me Bluetooth për çiftim

- Mbani shtypur  për 3 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit me Bluetooth, dhe pastaj përpikuni përsëri.

Nuk lidhem dot me pajisjen me Bluetooth

- Funkcioni Bluetooth i pajisjes suaj nuk është aktivizuar. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes suaj për të mësuar se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky boks nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Ky boks është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni dhe përpikuni përsëri.

7 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim në pajisje, që nuk është miratuar shprehimisht nga **MMD Hong Kong Holding Limited** mund ta bëjë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Pajtureshmëria



Këtu **TP Vision Europe B.V.** deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Deklaratën e konformitetit mund ta gjeni në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.




Ky simbol do të thotë që produkti përmban bateri që mbulohen nga direktiva evropiane 2013/56/EU, të cilat nuk mund të hidhen bashkë me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Hedhja e baterive të brendshme

Sigurohuni që produkti është i shkëputur nga energjia para se të hiqni baterinë e brendshme.



Vetëm për qëllim ilustrimi

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilen (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Lutemi, respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të harxhuara dhe pajisjeve të vjetra.

Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë të nxehtë, ose shtypja mekanike apo prerja e baterisë, të cilat mund të shkaktojnë shpërthim

Deklarata FCC dhe IC

Informacioni FCC

Pajisja i përmbahet rregullave FCC, pjesa 15. Operimi është subjekt i dy kushteve të mëposhtme:

- ① Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe.
- ② Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojë operim të padëshiruar.

Paralajmërim: Ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Shënim: Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC.

Këto limite janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient banimi.

Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të veçantë. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë e cila mund të përcaktohet duke e ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të përpiqet ta ndreqë interferencën nëpërmjet një ose më shumë prej masave të mëposhtme: (1) Ndryshoni orientimin ose lëvizni antenën. (2) Largoni distancën mes pajisjes dhe marrësit. (3) Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi. (4) Konsultohuni me shitësin ose me një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë.

Deklarata e paralajmërimit për RF

Pajisja është vlerësuar se i përmbush kërkesat e përgjithshme të ekspozimit RF. Kjo pajisje mund të përdoret në kushte portative ekspozimi pa kufizime.

IC-Canada: CAN ICES-3(B)/NMB-3(B)

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë.
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

Njoftim për markën tregtare



Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga **MMD Hong Kong Holding Limited** bëhet me licencë.

Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.



Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë.

Ky produkt prodhohet dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited dhe ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

TAS4807_00_UM_V1.0

